



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1082/10 prot.

Datë 08.05.2026

V E N D I M
Nr. 613/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.580/2026, datë 04.05.2026, për procedurën e prokurimit **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njezet e gjashte mije e nenteqind e pesedhjetë e tre pike gjashtedhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
- Ankimues:** OE “NET-GROUP” Shpk, me NIPT L72023002P, me adresa: Rruga Vorpset , pas restorant Piazza , ZK 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Lezhë
Adresa: L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen

e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 04.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.580/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NET GROUP” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-77318-02-24-2026, me objekt “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale te Fshatrave ne Njesite Administrative te Bashkise Lezhe”, me fond limit 14,443,130.28 (katermbedhjete milion e katerqind e dyzet e tre mije e njeqind e tridhjete pike njezet e tete) Lek pa Tvsh. **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njezet e gjashte mije e nenteqind e pesedhjete e tre pike gjashtedhjete e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.*
- 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “NET GROUP” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “NET GROUP” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

1.2. Me shkresën nr. 4481/5 prot., datë 06.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1082/7 prot., datë 07.05.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 580/2026, datë 04.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njezet e gjashte mije e nenteqind e pesedhjete e tre pike gjashtedhjete e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

-bashkëlidhur ka dërguar edhe procesverbalin e rivlerësimit me nr. 2204/14 prot., datë 06.05.2026 (vendimi KVO nr.03, datë 06.05.2026), nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 4481/5 prot., datë 06.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1082/7 prot., datë 07.05.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 580/2026, datë 04.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njetzet e gjashte mije e nenteqind e pesedhjetë e tre pike gjashtedhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

-bashkëlidhur ka dërguar edhe procesverbalin e rivlerësimit me nr. 2204/14 prot., datë 06.05.2026 (vendimi KVO nr.03, datë 06.05.2026), nënshkruar nga anëtarët e KVO-së;

II.2. Nga verifikimi i procedurës në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “NET GROUP” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura, në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.580/2026, datë 04.05.2026, sipas së cilit, ka kualifikuar operatorin ekonomik ankimues Net Group shpk.

Gjithashtu, bashkëlidhur informacionit, ka dërguar edhe procesverbalin e rivlerësimit me nr. 2204/14 prot., datë 06.05.2026 (vendimi KVO nr.03, datë 06.05.2026), nënshkruar nga anëtarët e KVO-së.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, **Loti II-te: REF-77322-02-24-2026**, me objekt: **Loti II-te:** “Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: “Sistemimi dhe Asfaltimi i Rrugeve Rurale ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht, Dajç dhe Ungrej”, me fond limit për Lotin II-të: 8,326,953.62 (tete milion e treqind e njetzet e gjashte mije e nenteqind e pesedhjetë e tre pike gjashtedhjetë e dy) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

